



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike

dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit për asistencën teknike për sistemin e ujësjellës-kanalizimeve”.
2. Projektligji “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.
3. Projektligji “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Pirro Lutaj, A. Prenga, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi, Petrit Vasili

Të ftuar:

Guri Aliaj - përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve pranë
Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës

Qirjako Qirko - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme

Armand Skapi - drejtor i Traktateve në Ministrinë e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit për asistencën teknike për sistemin e ujësjellës-kanalizimeve”, projekt i shtyrë nga mbledhja e mëparshme. Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës është i pranishëm zoti Guri Aliaj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Ju lutem bëni një prezantim të shkurtër të projektit, megjithëse është një projekt i parë nga kolegët edhe nga mbledhja e mëparshme, për shkak se është i mbartur, por gjithsesi edhe për efekt procedural.

Guri Aliaj – Projekti në fjalë ka të bëjë me asistencën teknike në kuadrin profesional. Vetë sistemi ekzistues i ujësjellës-kanalizimeve dhe gjendja me tregues jo të mirë e bëjnë të nevojshëm vazhdimin e asistencave teknike me grante të huaja. Kjo asistencë teknike profesionale konsiston në detajimin e saktë të ndërmarrjeve ekzistuese, numrin e punonjësve, profesionin e tyre, arsimin përkatës, vendosjen e kriterëve për të ardhmen nga pikëpamja profesionale në kuadrin e reformës që do të kryhet, sa do të jetë numri i punonjësve, si do të jenë profesionet e tyre, asistencë teknike në ndërmarrje. Kryesisht janë përzgjedhur 13 ndërmarrje në të gjithë Shqipërinë, pra ato ndërmarrje që nuk kanë pasur në kohën e shkuar asistencë dhe që kanë më shumë probleme. Qëllimi i këtij projekti është që në fund të ketë kriterë të sakta profesionale se si do të jenë ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, ndërmarrjet e mëdha, ndërmarrjet që do të krijohen në bazë të bashkive të reja, ndërmarrjet që do të krijohen në bazë të reamilizimit, sa do të jetë numri i punonjësve, si do të jetë arsimi i tyre, si do të jetë shkalla profesionale e tyre në bazë të numrit të popullsisë, në bazë të numrit të lidhjeve, në bazë të inventarit të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje?

Relatori, zoti Peza, dakord?

Dashamir Peza - Dakord.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim.

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Në tërësi. Dakord.

Faleminderit.

Miratohet.

Marrëveshja t’i kalojë komisionit përgjegjës për shqyrtim.

Faleminderit, zoti Aliaj.

Sekretar

Armando Subashi

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike

dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Pirro Lutaj, A. Prenga, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi, Petrit Vasili

Të ftuar:

Qirjako Qirko - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme

Armand Skapi - drejtor i Traktateve në Ministrinë e Jashtme

Fatmir Xhafaj - Pika e dytë e rendit të ditës. Është në shqyrtim projektligji “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”. Komisioni ynë nuk ka qenë komision i parashikuar për dhënie mendime lidhur me këtë projekt nga Konferenca e Kryetarëve. Komisioni i Jashtëm, që është komisioni përgjegjës, ka adresuar një kërkesë ndaj komisionit tonë për të shqyrtuar përmbajtjen e tre neneve të këtij projektligji, për t’u shprehur për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e atyre tri dispozitave, të cilat ne sot do t’i marrim në shqyrtim. Relatore është zonja Hysi.

Po, zoti Bylykbashi, për procedurë!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që nga mbledhja e fundit që kemi pasur si komision nuk është se ka ndryshuar gjë dhe sigurisht ky si një ndër komisionet më të rëndësishme të këtij parlamenti nuk mund të jetë as me sy të mbyllur, as me vesh të mbyllur, është në korrent të gjithë asaj që ndodh. Kemi kërkuar ose dorëheqjen e Kryetarit të Kuvendit, ose do të shqyrtohet një kërkesë, një mocion për shkarkimin e tij, për një arsye shumë të fortë, akuzat janë shumë të forta, le t’i provojë drejtësia. Por ne kemi kërkuar që Kryetari i Kuvendi të mos shkojë me imunitetin që i jep posti i tij. Tani, ju lutem, vetëm dëgjoni çfarë ka deklaruar zoti Meta.

Jap dorëheqjen, shkurt fare është...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti kryetar, e vlerësoj shumë durimin vetëm dy minuta.

Zoti Meta katër vjet më parë ka deklaruar: “Jap dorëheqjen e parevokueshme si Ministër i Ekonomisë dhe zëvendëskryeministër. Ja kam komunikuar Kryeministrit dhe pas këtij momenti jam në dispozicion të prokurorisë për hetim”. Më tej vazhdon: “Ky ka qenë dhe mbetet vendimi im personal dhe mbetet gjithashtu i parevokueshëm. Nuk mund të paraqitem si zëvendëskryeministër dhe ministër në prokurori”.

Opozita vetëm kaq kërkon, që zoti Meta t’i drejtohet prokurorisë jo me funksionin e tij si numri dy i shtetit, por t’i drejtohet si një deputet i thjeshtë, për të mos ushtruar asnjë lloj presioni, të mos ketë presion si ai që kemi parë këto ditë, ku funksionet më të larta të shtetit kanë shkuar për t’i dhënë prokurorisë versionin e tyre, duke i kërkuar zbardhjen e versionit të tyre dhe

asnjë lloj versioni tjetër. Për rrjedhojë, nuk mund të ketë punë të këtij parlamenti sikur nuk ka ndodhur gjë. Kërkojmë që axhenda e këtij komisioni të mos vazhdojë derisa të zgjidhet kjo çështje. Kjo është kërkesa jonë procedurale, përndryshe është e kotë që ne të diskutojmë, të flasim për projektligje, ndërkohë kemi akuzat më të rënda që janë bërë ndonjëherë për numrin dy të shtetit, pra për kreun e këtij parlamenti.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kjo ishte kërkesa juaj procedurale. Është një kërkesë tërësisht dhe absolutisht absurde. E para, sepse, siç thatë edhe ju vetë, është drejtësia duke punuar, por në vend të drejtësisë ju keni përzgjedhur rrugën e llomotitjeve politike. Kjo është e drejta juaj. Siç e përmendët edhe ju, ka një mocion të kërkuar po nga ju, për këtë çështje, por që fatkeqësisht ajo që është absurde dhe e bën më qesharake çështjen është se zotërinjtë e opozitës drejtojnë Këshillin e Legjislacionit, i cili duhet të mbledhet për t'i hapur rrugë mocionit që ka firmosur zoti Meta, në reagim të kërkesës së deputetëve të opozitës.

Zotërinjtë e opozitës nuk mbledhin Këshillin e Legjislacionit, por i kërkojnë Komisionit të Ligjeve që të ndërpresë mbledhjen. Pra, ajo që është institucionale është mbledhja e Këshillit të Legjislacionit, të cilin nuk e mbledhin, e kanë ata të drejtën dhe detyrën në këtë rast dhe i kërkojnë Komisionit të Ligjeve të ndërpresë procedurën normale. Kjo është tërësisht absurde.

Për më tepër, më kujton zoti Subashi, këtë Këshill e drejton, sipas sistemit të rotacionit një nga kolegët tanë të opozitës, zoti Halimi, i cili largohet nga ky komision, për t'i thënë komisioni ndërpritu ti, por që unë të mos e mbledh atë komisionin. Kjo është një situatë jo thjesht procedurale, por sa është për të ardhur keq, aq është edhe qesharake.

Po, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Mendoj që nuk zgjidhim asnjë gjë duke hyrë në interpretime të njëri-tjetrit, kështu siç po bëhet. Opozita në të drejtën e vet ka kërkuar që parlamenti të mbajë një qëndrim, dhe në mënyrë të veçantë Komisioni i Jashtëm në raport me një çështje pa paragjykuar fajësi. Këtë e them edhe një herë, pa paragjykuar fajësinë e kurrkujt, por kërkon që të ketë një proces transparent, një debat serioz brenda Kuvendit të Shqipërisë, për këtë çështje dhe pastaj veprimi, sipas të gjitha hallkave të tjera ligjore dhe institucionale. Kështu që çdo lloj interpretimi që bëjmë ne, vetëm shton ndonjë debat të pavlerë, sepse ne nuk zgjidhim asnjë gjë. Të gjithë biem dakord që ka krijuar një shqetësim publik dhe kërkon një përgjigje. E them edhe një herë nuk ka asnjë qëndrim të opozitës për të vendosur gishtin e fajësisë mbi kërkënd. Nuk është e

drejta jonë, as nuk e kemi bërë dhe as nuk e bëjmë, por të mos hyjmë në interpretimet e njëri-tjetrit. Ne e gjykojmë legjitime edhe kërkesën që është parashtruar nga kolegët, natyrisht duhet të veprojnë të gjitha hallkat nga Komisioni i Ligjeve, po ashtu edhe Këshilli i Legjislacionit për të arritur në përfundimin që duhet.

Kuvendi i Shqipërisë duhet të funksionojë në bazë të Rregullores, në bazë të normave dhe në bazë të raportit politik dhe moral që merr gjithsecili, si deputet apo si grup parlamentar.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu, unë e mirëkuptoj këndvështrimin tuaj politik, por e vlerësoj edhe qasjen tuaj konstruktive, ku ju thatë me shumë të drejtë që Kuvendi duhet të veprojë sipas Rregullores. Më jepni një mundësi në Rregullore që unë të veproj sipas asaj kërkesë të opozitës, një. Më jepni. Çfarë? Po si? Po nuk dua të bëj debat, por është absurde kjo që bëjnë. Është e thjeshtë në pamundësinë që të bëjnë një gjë tjetër.

Fatmir Mediu – Atëherë do të ishte shumë më e mirë pasi ju jeni kryetar i komisionit, të uleni me përfaqësues të opozitës për të arritur në një diskutim para se të vijmë këtu mediatikisht apo publikisht, se cilat janë problemet dhe si mund të zgjidhen ato, qoftë në përgjegjësinë tonë si opozitë, qoftë edhe në përgjegjësinë tuaj si maxhorancë, apo përgjegjësinë tuaj si kryetar i Komisionit të Ligjeve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se u dëgjuan një pro dhe një kundër. Gjëja është e thjeshtë, këtu nuk ka asnjë indice procedurale, kështu që jemi të detyruar të vazhdojmë me procedurën e zakonshme, që do të thotë me shqyrtimin e projektligjit “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

Nga Ministria e Jashtme është zoti Qirjako Qirko, sekretar i Përgjithshëm. Faleminderit, zoti Qirko! Së bashku me të është edhe zoti Armand Skapi, drejtor i Drejtorisë së Traktateve.

Zoti Qirko, ju lutem na bëni një ekspozitë të shkurtër të projektit. Siç besoj, jeni në dijeni që ne nuk fokusohemi në gjithë projektin. Në tre nene jemi investuar me kërkesë të Komisionit të Jashtëm, që janë nenet 7, 8 dhe 9. Një paraqitje shumë të shkurtër të projektit dhe natyrisht një përqendrim te këto tre dispozita.

Qirjako Qirko – I nderuar kryetar i Komisionit të Ligjeve,

Të nderuar anëtar të komisionit,

Është kënaqësi dhe nder për ne si përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme të parashtrorjme përpara jush, përpara këtij komisioni të nderuar vlerësimin tonë për disa aspekte të

veçanta të projektligjit të ri “Për shërbimin e jashtëm”. Dëshiroj të informoj paraprakisht që projektligji i ri i shërbimit të jashtëm është i treti në radhë për sa i përket rregullimit me akte ligjore të shërbimit të Jashtëm. Projektligji i parë është miratuar në vitin 1998, ka qenë një ligj skematik, i cili është përpjekur të vendosë themelet e këtij shërbimi.

Ligji i dytë i vitit 2003 bën një rregullim më tërësor të aktivitetit të shërbimit të jashtëm, ndërsa projekti që paraqesim për miratim sot është ligji ndoshta më i plotë. Por duhet të them që paraprakisht për të tria aktet është marrë përvoja më e mirë e vendeve, të cilat për nga ambiciet dhe për nga niveli i shërbimit janë të krahasueshme me ne.

Mendojmë që ky ligj i shërben më së miri realizimit të të gjitha objektivave që qeveria ka në politikën e jashtme. Referuar specifikisht tre neneve që ju përmendët, më duhet të them që të tre këto nene janë pjesë e akteve ligjore, që kanë të bëjnë me shërbimin e jashtëm.

Referuar bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë dhe me Presidentin e Republikës, në këtë projekt nuk sjellim gjë të re, pasi pak a shumë janë marrë formulimet nga ligji i vitit 2003. E reja, siç mund ta konsiderojmë, që sjellim në këtë fushë është bashkëpunimi me ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore.

Jemi përpjekur që në këtë nen, saktësisht në nenin 9 të bëjmë një rregullim tërësor të këtij aktiviteti, duke e përqendruar konsulencën, bashkëpunimin te Ministria e Jashtme. Ky model adoptohet sot, në mënyrë absolute, nga të gjitha vendet. Dua të sqaroj, nuk është cenim i sovranitetit, i pavarësisë së organeve të pushtetit vendor apo i institucioneve të tjera qendrore, është një rregullim, të cilin e kanë të gjitha shtetet në mënyrë absolute. Gjithçka që ka të bëjë me politikën e jashtme të vendit adresohet fillimisht në Ministrinë e Jashtme, sepse politika e jashtme është një nga ato sferat e veprimtarisë shtetërore, që ka gëzuar gjithmonë një mbështetje nga të gjitha palët dhe për këtë arsye, edhe për të sanksionuar seriozitetin e shtetit, qëndrimet e njëjta për çështjet kryesore roli i Ministrisë së Jashtme për këtë projektligj është i tillë, që ndihmon organet e pushtetit vendor, ndihmon institucionet e tjera qendrore për të mbajtur qëndrimet në koherencë të plotë me ato të qeverisë.

Kjo është edhe arsyeja se pse në paragrafin e dytë të nenit 9 ne kemi vendosur kërkesën që për çështjet e politikës së jashtme, qoftë edhe për korrespondencën, gjithçka të kalojë nëpërmjet Ministrisë së Jashtme, pra nuk është një kufizim i pavarësisë së tyre, por është një disiplinim i domosdoshëm dhe në thelb ka të bëjë me seriozitetin e shtetit. Kaq mund të them, dhe nuk e di nëse ka pyetje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Zonja Hysi, si relatore.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Faleminderit edhe përfaqësuesve të Ministrisë së Jashtme për sqarimet.

Sikurse ju vuri në dijeni edhe kryetari i komisionit, Komisioni i Politikës së Jashtme ka kërkuar nga komisioni ynë dhënien e mendimit vetëm për tri nene, të projektligjin e ri “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe konkretisht për nenet 7, 8 dhe 9.

Neni 7 bën fjalë për bashkëpunimin e Shërbimit të Jashtëm me Kuvendin, dhe në projektligj ka një rregullim, i cili nuk është i ri por ka ekzistuar edhe në ligjet e mëparshme. I vetmi ndryshim që bëhet është numërtimi ose pozicioni i këtij neni në lidhje me nenet e tjera. Pra, në ligjin e vjetër ka qenë neni 3, kurse në ligjin e ri ka marrë numërtimin neni 7.

Nga pikëpamja e kompetencës që ka komisioni ynë ne diskutojmë vetëm kushtetutshmërinë dhe përputhjen ligjore. Pra, këtë nen duhet ta shohim në përputhje me Kushtetutën.

Nga studimi që i kanë bërë Kushtetutës, rregullores së Kuvendit, por edhe projektligjit unë nuk shoh asnjë përplasje legjislative nga pikëpamja kushtetuese apo ligjore me Kushtetutën dhe rregulloren e Kuvendit.

Shërbimi i Jashtëm realizon politikën e jashtme në Republikën e Shqipërisë dhe në këtë kuadër është e domosdoshme që të ketë një bashkëpunim me Kuvendin, aq më tepër që Kuvendi është një institucion i rëndësishëm, i cili jo vetëm ratifikon dhe miraton ligjet të rëndësishme, por njëkohësisht deputetët marrin pjesë në delegacioneve, janë pjesëtarë të delegacioneve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Në këtë kuadër është e domosdoshme, që të kenë informacion lidhur me qëndrimet që duhen mbajtur, për sa i përket çështjeve të rëndësishme të politikës së jashtme.

Neni 8 i projektligjit bën fjalë për bashkëpunimin me Presidentin e Republikës. Edhe ky nen nuk është i ri, pasi ka ekzistuar edhe në ligjin e mëparshëm. Përsëri ka një rinumërtim, ndryshim të pozicionit të tij dhe në kuadër të pasjes së një ligji të ri, është mëse e domosdoshme që të ketë një bashkëpunim midis Shërbimit të Jashtëm dhe institucionit të Presidentit të Republikës.

Ju e dini që deri më sot ne nuk kemi një ligj të veçantë që të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucionit të Presidentit të Republikës. Në relacionin që ju kam vënë në dispozicion, kam parë përputhshmërinë e këtij neni vetëm me Kushtetutën e Republikës

së Shqipërisë, dhe konkretisht janë dy nene që kanë interes për ne dhe është neni 86 i Kushtetutës, i cili përcakton se: “Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”, dhe neni 92 përcaktohen funksionet dhe kompetencat e Presidentit të Republikës.

Nuk ju kam sjellë në vëmendjen tuaj të gjitha kompetencat, por kam përmendur tre nga kompetencat më të rëndësishme që ka Presidenti lidhur:

a) me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;

b) pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

c) lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit;

Të mos harrojmë që Presidenti merr pjesë në shumë delegacione, veprimtari ndërkombëtare dhe ushtron një sërë detyrash dhe ka nevojë të informohet nga Shërbimi i Jashtëm. Pra, është e qartë që Presidenti i Republikës dhe Ministria e Punëve të Jashtme duhet të kenë bashkëpunim me njëri-tjetrin.

Ministria e Punëve të Jashtme duhet ta informojë Presidentin e Republikës lidhur me çështjet e politikës së jashtme dhe me kërkesë të tij, ose me iniciativë mund të japë mendime dhe propozime për veprimtarinë kombëtare, që kryhen nga Presidenti i Republikës.

Nga pikëpamja Kushtetuese përmbajtja e këtij neni nuk bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në aspektin praktik do të ishte mirë, që marrëdhëniet e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Presidentin e Republikës së Shqipërisë të funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të shëndetshme.

Neni 9 i projektligjit ka pësuar ndryshime, në krahasim me tri nismat ose tri ligjet që kanë ekzistuar deri më sot. Ky nen bën fjalë për bashkëpunimin midis ministrive me institucioneve qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, pra, kemi tri kategori institucionesh për të cilat flitet.

Risia në këtë nen në krahasim me nenet e tjera është se futen dy elemente, pra bashkëpunimi me këto institucione rregullohet edhe në ligjet që kanë ekzistuar, por në këtë ligj ka dy risi:

E para, ministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore dhe organet e qeverisjes vendore përpara se të marrin veprime, të kryejnë ose të presin vizita në nivel ndërkombëtar, të mbajnë

qëndrime, ose të bëjnë deklarata për çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë, duhet të marrin miratimin dhe udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Pra, miratimi është elementi i ri.

Elementi i dytë i ri, sikurse tha edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme është se komunikimi midis ministrive, institucioneve qendrore dhe organeve të pushtetit vendor duhet të bëhet nëpërmjet misionëve diplomatike të Republikës së Shqipërisë ose misionëve të akredituara në Shqipëri dhe duhet të bëhet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. Pra, nëse një kryetar bashkie apo një ministër do të vendosë lidhje bashkëpunimi, komunikimin do ta bëjë nëpërmjet përfaqësuesve diplomatikë. Përmbajtja e këtij neni duhet parë me një sërë nenesh të Kushtetutës.

Së dyti, duhet ta analizojmë në raport me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore” të ndryshuar” dhe me rregulloren e Kuvendit. Unë kam shtruar këtu për diskutim tri çështje:

Çështja e parë është analiza e atij detyrimi që shtrohet në projektligj, që institucionet qendrore duhet të marrin miratim nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Në fakt, neni 6 i projektligjit flet për funksionet e Shërbimit të Jashtëm dhe në pikën d) theksohet se: “Bashkërendimi i veprimtarisë me jashtë i institucioneve qendrore–vendore është kompetencë ose do të jetë kompetencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme”. Kjo është mëse normale dhe nuk mundet që në një shtet institucionet të flasin me gjuhë të ndryshme ose të mbajnë qëndrime të ndryshme për probleme të politikës së jashtme, dhe që mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e shtetit shqiptarë me shtetet e tjera. Pra, çdo ministri, çdo institucion qendror ose organ vendor ka të drejtë të bëjë shkëmbime, të flasë për çështje që janë brenda kompetencave të tij, por për sa u përket çështjeve të politikës së jashtme është e mirë të jetë në bashkëpunim, në konsultim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ministria e Punëve të Jashtme në këtë rast jo vetëm që unifikon qëndrimet që mund të mbajnë ministrat e ndryshëm ose drejtues të institucioneve të ndryshme, por njëkohësisht edhe koordinon politikën e jashtme. Shqetësimi që unë kam është te termi që përdoret “institucione qendrore”.

Nëse i referohemi ligjit por edhe faqes së internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në institucione qendrore nuk janë vetëm ministratë por janë edhe institucione të tjera qendrore siç janë: Presidenti, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, por njëkohësisht në bazë të ligjit 9000 “Për

organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, mund të krijohen në varësi të Kryeministrit ose ministrave edhe institucione të tjera qendrore. Ne duhet të jemi më të kujdesshëm në parashikimin e klauzolës se miratimi është pikërisht marrëdhëniet e Ministrisë së Punëve të Jashtme me institucionin e Presidentit, me të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave.

Në fakt, unë mendoj që këtu ka një lapsus, sepse, po të shikojmë nenin 13 të projektligjit, marrëdhëniet e këtyre 3 institucioneve të rëndësishme rregullohen më vete, dhe te neni 13 thuhet se përveç funksioneve të përgjithshme të Shërbimit të Jashtëm, Ministria e Punëve të Jashtme bashkërendon qëndrimet zyrtare për institucionin e Presidentit, të Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera të politikës së jashtme. Pra, unë jam në favor që Ministria e Punëve të Jashtme për këto të tri institucione qendrore duhet të bashkërendojë, por nuk mund të miratojë dhe t’i kërkojë Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë apo ministrit të Jashtëm të bëjë vizitë në këtë vend apo jo, ose t’i kërkojë Kryeministrit apo ministrit të Punëve të Jashtme ta bëjë këtë vizitën, apo jo.

Padyshim si Presidenti, si kryetari i Këshillit të Ministrave, si Kryetari i Kuvendit kanë nevojë dhe janë ata që kërkojnë informacion nga Ministria e Punëve të Jashtme për qëndrimet që duhen mbajtur apo për diskutimet e problematikës.

Në këtë kuadër në rast se rregullojmë këtë terem për këto tri institucione ne mund të heqim çdo hamendësi ose keqinterpretim nga ata që duan ta keqinterpretojnë këtë pikë të ligjit.

Për sa i përket ministrave Kushtetuta në nenin 102, pika 4 të saj thekson: “Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë”. Ndërkohë që ky rregullim që bëni në projektligj nuk bie ndesh me nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, sepse ne na ndihmon edhe ligji 9000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cili përcakton që ministrat përveç kompetencave që kanë, kryejnë edhe detyra të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera. Kështu që, edhe detyrimi që mund të kenë ata për të koordinuar dhe bashkërenduar me Ministrinë Punëve të Jashtme është mëse normale.

Çështja e dytë ka të bëjë me detyrimin e drejtuesve të institucioneve vendore për të marrë miratim nga Ministria e Punëve të Jashtme. Ju dini që Kushtetuta ka një sërë nenesh në kreun 6, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe kompetencat e tyre, dhe konkretisht në nenin 109 pika 4 të Kushtetutës i njihet e drejta organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, që të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera si dhe të

përfaqësojnë organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, dhe kjo është e drejtë Kushtetuese. Gjithashtu, po në Kushtetutë sanksionohet që qarku është njësi ku ndërton –zbaton politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikat shtetërore. Neni 112 pika 2, e Kushtetutës, duhet të jetë në vëmendjen tonë ku thuhet: “Organeve të qeverisjes vendore mund t’u vihen detyrime vetëm në përputhje me ligjin ose sipas marrëveshjeve që ato lidhin.”

Në këtë kuadër unë kam studiuar edhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e organeve qeverisjes vendore”, i cili në nenin 8 parashikon të drejtën për bashkëpunim dhe në këtë nen thuhet: “Njësitë vendore bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësojnë organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Pra, rëndësi ka që kjo e drejtë të jetë parashikuar në një ligj dhe nëse kjo e drejtë është parashikuar në ligj nuk ka asnjë pengesë.

Shqetësimi i vetëm që është mirë ta diferencojmë është pikërisht dallimi, që duhet të bëjmë midis marrëdhënieve që kanë organet e qeverisjes vendore, kur ka çështje që kanë të bëjnë me politikën e jashtme me shkëmbimet në kuadër të projekteve ndërrajonale, që mund të kenë binjakëzime, projekte teknike dhe atyre që nuk kanë lidhje fare me politikën e jashtme. Pra, miratimi të kërkohet atëherë kur kërkohet të mbahen qëndrime që kanë të bëjnë me çështje të politikës së jashtme, sepse unë mendoj që Ministria e Punëve të Jashtme do ta ketë shumë të vështirë të koordinojë çdo lloj vizite të çdo kryetari bashkie, të çdo institucioni, të çdo nëninstitucioni, edhe kur ata bëjnë shkëmbim përvojash dhe seminaresh që kanë karakter teknik dhe nuk kanë të bëjnë me politikën jashtme. Lidhur me termin miratim që ju përdorni duhet treguar kujdes në këtë lloj shkëmbimesh që janë të karakterit thjesht teknik dhe nuk kanë të bëjnë me qëndrime politike apo me deklarata lidhur me politikën e jashtme.

I nderuar zoti kryetar, këto ishin tre nenet që unë kam studiuar dhe që ju paraqita, dhe rezervoj të drejtën për të bërë komente lidhur me nenet e tjera përderisa kjo nuk është kërkuar nga komisioni përgjegjës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Ka ndonjë koment Ministria e Jashtme?

Qirjako Qirko - Do të doja të sqaroja, që në asnjë mënyrë nuk ka qenë qëllimi i këtij ligji që të përcaktonte detyrimin e titullarëve më të lartë të shtetit Presidentit, Kryeministrit apo Kryetarit të Kuvendit të merrte leje. Absolutisht jo. Domethënë kur flasim për hierarki institucionale, ministri i Jashtëm mund të miratojë lëvizjet në nivel homologësh të tillë dhe

gjithçka që ka poshtë. Në mënyrë absolute nuk ka qenë ndonjëherë. Ky ka qenë dhe përcaktimi i mëparshëm edhe në ligjin e shërbimit të jashtëm. Lidhur me këto autoritete kontributi i Ministrisë së Jashtme ka qenë pikërisht fjala vjen, kur Presidenti niset për një vizitë zyrtare në Katar, në mos gabo, dhe si në çdo rast Ministria e Jashtme është ajo që përgatit tezat dhe gjithë informacionin e duhur për zhvillimin me sukses të kësaj vizite. Dhe kjo është e përhershme. Pra, ky aktivitet tashmë është i konsoliduar. Nuk bëhet fjalë, sepse nuk mundet ministri i Jashtëm të miratojë. Pra, me autoritetet më të larta të shtetit, raporti i Ministrisë së Jashtme është vetëm raport ndihmës, jo raport mbikëqyrës. Kjo është për çështjen e parë.

Për sa i takon pavarësisë së autoriteteve të pushtetit vendor edhe në këtë çështje roli i Ministrisë së Jashtme është ndihmës, por njëkohësisht edhe koordinues, duhet të kemi parasysh që në politikën e jashtme çdo vizitë, çdo shkëmbim informacioni, çdo letër, çdo përshëndetje është mesazh, dhe këto mesazhe duhet të jenë në përputhje me nivelin e marrëdhënieve që kemi me vendet konkrete. Ne të gjithë jemi dëshmitarë që në momente të caktuara, kur marrëdhëniet me një shtet të caktuar nuk kanë qenë në nivelin e duhur, kemi pasur shmangie nga ky qëndrim kur autoriteteve të pushtetit vendor për shkak të mosnjohjes së çështjeve, thjesht iu vinte një vizitë dhe shkonin në një vizitë, pra, për të shmangur shfaqje të tilla që dëshmojnë mungesë serioziteti, ne e kemi vënë që roli i Ministrisë së Jashtme në raport me pushtetin vendor është ndihmës. Pra, ashtu si për autoritetet e tjera edhe lidhur me kryetarët e bashkisë apo me autoritete të tjera Ministria e Jashtme përgatit teza dhe informacionin e duhur dhe nëse niveli politik i marrëdhënieve me shtetin është i tillë që nuk justifikon realizimin e një vizite apo një kontakt të shtuar me këtë vend, atëherë kjo u duhet bërë e qartë drejtuesve të pushtetit vendor që të kenë kujdes, sepse qoftë fluksi i vizitave, qoftë mesazhet që mund të jepen nuk përkojnë me atë qëndrim të politikës së jashtme. Ky është qëllimi i këtij neni.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë mendoj se vërejtjet e deputetes Hysi kanë mjaft vlerë duke i diskutuar jo vetëm nga pamja juridike, por dhe diçka më gjerë. Dhe në vazhdim të asaj që tha sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme, unë besoj se qëllimi ka qenë pikërisht kështu, por mendoj që dikush mund të keqinterpretojë natyrën të ndryshme të frazave që janë përdorur në ligj. Duke pasur parasysh se politika e jashtme, pavarësisht se është një e drejtë e ekzekutivit, pra specifikisht e Ministrisë së Jashtme për t'u aplikuar, ka një rëndësi të një natyre tjetër. Ajo nuk

është vetëm pjesë e një programi të një qeverie, por ka disa detyrime të cilat kanë të bëjnë me kontinuitetin dhe nuk mund të konsiderohen thjesht dhe vetëm ekskluzivitet i ekzekutivit. Prandaj mendoj se disa shqetësime duhen trajtuar nga këndvështrimi që politika e jashtme shpesh kërkon edhe opinionin e rëndësishëm të opozitës, duke pasur parasysh këtu që kur ky opinion është shmangur, ne kemi pasur gafa, siç është marrëveshja e detit me fqinjin tonë të rëndësishëm, e cila tani është kthyer në një vrimë të zezë në marrëdhëniet midis dy vendeve. Kështu që ky ekskluzivitet i Ministrisë së Jashtme mendoj se duhet parë dhe nga këndvështrimi i atyre që nuk duhet të përsërisim. Nga kjo pikëpamje mendoj se disa definicione mund të shikohen. Për shembull, kam propozimin që në nenin 7 “Bashkëpunimi me Kuvendin”, paragrafi ku thuhet se Ministria e Punëve të Jashtme brenda detyrave dhe përgjegjësi të veta njofton Kuvendin, ne jemi republikë parlamentare, Kuvendi nuk është për njoftime, por për dhënie informacioni, si institucioni më i lartë llogarikërkues, jo njoftues. Mbase është e rëndësishme të thuhet që jo informon Kuvendin, por informon Komisionin e Politikës së Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme, duke e përcaktuar qartazi këtë marrëdhënie midis Ministrisë së Jashtme dhe Kuvendit. Nga ana tjetër, mendoj se vërejtja e zonjës Hysi, që ka të bëjë me bashkëpunimin e ministrive me institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, pra mendoj se shprehja “institucionet qendrore” duhet hequr. Unë nuk e di, por institucioneve qendrore t’u japësh miratimin dhe udhëzimin e ministrit të Jashtëm detyruet që duhet të shprehen kështu apo ashtu, mendoj se mund të shfaqë keqkuptime. Unë jam absolutisht dakord me atë që tha sekretari i Përgjithshëm, që qëllimi është që të koordinohet në një shkallë sa më të gjerë, sepse ka shpesh drejtues institucionesh që flasin në mënyra të ndryshme për gjëra të njëjta. Ndoshta këtu presioni i Ministrisë së Jashtme dhe mendoj se kjo ka qenë kërkesa, që të ketë një standardizim të gjuhës diplomatike edhe kur vijnë nga institucione të cilat nuk kanë të bëjnë me politikën e jashtme. Por mbase duhet gjetur një mënyrë pak më diplomatike, meqenëse po flasim për politikën e jashtme dhe këtu e kam për të përkrahur zonjën Hysi.

Për sa i përket marrëdhënieve me Presidentin, mendoj se zonja Hysi me shumë të drejtë përsëriti nenet e Kushtetutës. Ato duhet të mbeten ashtu siç janë të shkruara ose të ripërsëritura. Nenet e Kushtetutës ne nuk mund t’i interpretojmë, por thjesht t’i rishkruajmë dhe t’i zbatojmë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Që të jem i sinqertë unë nuk jam dakord edhe me formulimin e Ministrisë edhe me atë çfarë u tha këtu. Logjika ime është pak më ekstreme edhe nga kjo që

është mbajtur këtu për shkak se unë e konsideroj të domosdoshëm mendimin e Ministrisë së Jashtme. Absolutisht të domosdoshëm. Ky është një shtet unitar, i cili ka institucionet e veta që janë përgjegjëse për politika të caktuara dhe në rastin konkret mund të ketë shumë institucione brenda vendit, mund të ketë shumë organe që kanë marrëdhënie me jashtë apo ushtrojnë funksione të larmishme brenda vendit, por në marrëdhëniet e shtetit me shtetet e tjera ka vetëm një. Nuk mund të ketë as dy, as tre, as katër qëndrime dhe Kushtetuta ia ka njohur këtë të drejtë ekskluzive, këtë përgjegjësi qeverisë dhe brenda detyrimit të qeverisjes ia ka njohur këtë gjë Ministrisë së Jashtme, e cila është ministria përgjegjëse. Në këtë kontekst nuk bëjmë fare gabim, përkundrazi, që për çdo lloj qëndrimi që ka të bëjë me politikën e jashtme dhe këtu duhet të bëjmë një dallim, me qëndrimet e shtetit shqiptar në politikën e jashtme duhet të jetë i njësuar dhe do të duhet patjetër një institucion që ta njësojë, ta harmonizojë, ta unifikojë këtë qëndrim. Në këtë kontekst mendoj se çdo lloj përcaktimi i njohjes së kësaj marrëdhënieje, të këtij detyrimi është veçse pozitiv. Për shembull, do të propozoja një zgjidhje, që unë e quaj absurde, që të ketë një ministër marrëdhënie shëf protokolli, këshilltar për marrëdhëniet me jashtë, zyrë për marrëdhënie me jashtë dhe ata nuk kanë asnjë mundësi komunikimi drejtpërdrejt me Ministrinë e Jashtme. Ndërkohë që mund të kishte një detyrim, ka shtete që aplikojnë që këshilltari i marrëdhënieve me jashtë, këshilltari diplomatik është pjesë e strukturës së Ministrisë së Jashtme që do të thotë se në qoftë se ministri merr një këshilltar diplomatik, ai duhet t'i drejtohet rrethit të njerëzve që ka Ministria e Jashtme. Dhe këtu ka shumë njerëz, ambasadorë, njerëz që kanë ushtruar veprimtari në shërbimin e jashtëm diplomatik, të cilët për një kohë të caktuar duke u njohur gjatë kësaj periudhe, edhe duke u njohur kjo si pjesë e mandatit të tyre si funksionar i shërbimit të jashtëm, mund të shërbejnë shumë mirë në këto institucione dhe të kenë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Jashtme. Pra, marrëdhënien financiare, administrative ai mund ta ketë me titullarin, edhe titullarin e institucionit qendror edhe titullarin e institucionit të organit të qeverisjes vendore, por marrëdhënien që ka të bëjë në thelb me substancën, për atë pjesë që i takon duhet ta ketë me Ministrinë e Jashtme. Ministria e Jashtme e trajnon, e udhëzon, e mban gjithmonë të abdejtuar, të përshtatur me politikën e jashtme, me qëndrimet që mban etj. Kështu kemi një urë komunikimi. Dhe nëse kemi një urë të tillë komunikimi çdo titullar i institucionit, ministri i institucionit qendror apo organ i qeverisjes vendore do të jetë shumë më në gjendje që ta përmbushë këtë përgjegjësi të tij. Por kjo do të unifikojë, do t'i japë dhe një dimension tjetër edhe kur takohen, edhe në vizitat që bëjnë brenda

apo jashtë vendit në marrëdhëniet me trupin diplomatik, në marrëdhëniet me partnerët e tyre ndërkombëtarë, në marrëdhënie me institucionet ndërkombëtare. Pra, do t'i japë dhe nga pikëpamja ceremoniale, protokollare pastaj edhe më tepër dhe dhënia e substancës do t'u japë një dimension tjetër, një vlerë tjetër gjithë këtyre institucioneve. Por mendoj se ligji do të duhet ta parashikojë këtë gjë, që do të thotë që nëse iks punonjës i shërbimit të jashtëm kontraktohet të punojë për 4 vjet, 5 vjet, 3 vjet për një kohë të caktuar në shërbimin e jashtëm të Kuvendit apo të bashkisë, apo të ministrisë, ose të një institucioni tjetër të shtetit që ka marrëdhënie të kësaj natyre, atij i njihet kjo pjesë si pjesë e mandatit të tij, sepse besoj se ka një mandat të shërbimit në shërbimin e jashtëm diplomatik. Vazhdon si vite të karrierës së tij diplomatike, mund të jetë këtu, pas ca kohësh mund të shkojë përsëri në shërbimin e jashtëm diplomatik, kështu që krijohet një lidhje organike dhe këtyre u jep një dimension tjetër në funksionimin, në këto komponente të rëndësishme, sepse po të kemi parasysh, për shembull, po marr rastin e institucioneve vendore, deri dje kishim 380-400 komuna e bashki, ndërsa sot kemi vetëm 61 dhe këto nuk janë pak, janë 61 bashki me shumë peshë në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Dhe ata janë personalitete vendore dhe do të duhet të kenë një qasje tjetër, një dimension krejt tjetër edhe në këtë aspekt të komunikimit ndërkombëtar për shkak të marrëdhënieve dypalëshe që kanë, për shkak të shkëmbimeve ekonomike që bëjnë. Dhe kjo do t'u jepte edhe atyre, jo më pastaj ministrive një dimension krejt tjetër, sepse pa dyshim që në qoftë se një ministër merr një njeri nga rruga dhe i thotë që ti je për marrëdhëniet me jashtë me mua, thjesht sepse ai ka një diplomë se ka mbaruar shkollën për komunikim në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, apo në filozofi apo në drejtësi, kjo nuk është e mjaftueshme, ai duhet të ketë dhe një përvojë për ta bërë këtë detyrë siç duhet bërë. Prandaj shpeshherë shikojmë gjëra siç thanë kolegët, që nuk bëjnë sens në këto lloj marrëdhëniesh. Unë do të mendoja që kjo gjë duhet specifikuar. Nga ana tjetër, mendoj që po marrim edhe inversin. Ju keni përcaktuar detyrimin që të marrë miratimin etj, por është dhe detyrimi që mbasi kthehet ai nga një vizitë, duhet të informojë. Kjo është një praktikë shumë e shëmtuar që ndodh te ne. Unë jam deputet, shkoj në emër të Kuvendit të Shqipërisë, në një vend dhe kur kthehem që andej nuk i çoj dy gisht letër Ministrisë e Punëve të Jashtme institucionit ku unë punoj në emër të të cilit kam shkuar me dieta dhe të cilit kam shkuar, me paratë e të cilit kam shkuar dhe t'i them që unë isha me shërbim, isha me këtë detyrë i ngarkuar nga institucioni, pata këto kontakte, pata këto qëndrime. Pse? E para jo thjesht për të bërë një informim formal, por kjo është dhe memorie, sepse ne nuk jemi të përjetshëm në karrige. Sot

jemi ne, nesër është dikush tjetër. Kjo do të thotë se ai tjetri që do të vijë do të shikojë këtu në Kuvendin e Shqipërisë apo në ministrinë iks dhe nëse nuk e gjeti të plotë këtu do ta gjej patjetër tek institucioni i specializuar i shtetit që është Ministria e Jashtme, se çfarë kam deklaruar dhe çfarë më kanë deklaruar, në mënyrë që kur të shkojmë te një vizitë tjetër të gjithë mos t'i themi atij palës tjetër: më fal, s'di gjë, se ka qenë një tjetër përpara. Jo, shteti është një, pavarësisht se kush hipën, kush ngrihet e kush ulet nëpër karrige. Shteti është një dhe duhet të sillet si i tillë.

Kështu që, unë mendoj se ligji duhet të përcaktojë edhe detyrimin tjetër, e nuk kemi asnjë pengesë kushtetuese e ligjore. Siç duhet të kem detyrimin, që unë të marr paraprakisht udhëzimet e nevojshme, gjë që e bëjmë të gjithë ne, besoj. Unë vetë e kam bërë, kolegët e kanë bërë, dhe besoj se është një praktikë normale dhe shumë e drejtë, por duhet të jetë një praktikë e rregulluar me ligj dhe anasjelltas.

Çështja tjetër ka të bëjë me shërbimin e jashtëm. Në rregull, dakord, është shumë mirë që është vendosur të ketë këto detyrime, që kanë të bëjnë me shërbimin, edhe në këto nene që po diskutojmë ne. Por, cili është niveli i shërbimit diplomatik jashtë, që ta mundësojë cilësinë e kësaj vizite, cilësinë e këtij shkëmbimi? Unë mendoj se kjo lë për të dëshiruar, dhe Ministria e Jashtme, me sa jemi në dijeni ne si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm. Ndoshta edhe ky ligj do të jetë një mundësi më shumë për të përmirësuar gjendjen.

Komisioni i Jashtëm, i cili është komision përgjegjës, do të shikojë tërësisht përmbajtjen e ligjit, nëse i plotëson këto pritshmëri, por ajo që do të duhet të artikuloj unë, edhe nga përvoja ime, është që shërbimi diplomatik jashtë lë për të dëshiruar, për shkak të nivelit dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrave.

Ne kemi pasur raste konkrete, që janë njoftuar dhe, jo vetëm që thjesht e vetëm nuk kanë bërë shërbimin e nevojshëm në këtë rast, por edhe ajo çfarë paraqesin, çfarë prezantojnë, që të mund të lehtësojnë këtë shkëmbim, lë shumë për të dëshiruar.

E fundit që kam, ka të bëjë me çështjen e institucioneve qendrore. Në pikëpamjen time, është absolutisht e domosdoshme për të vendosur. Natyrisht, kjo nuk besoj se adresohet, se në ligj ka një dispozitë të veçantë, që përcakton marrëdhënien me Presidentin, me Kuvendin, me Kryeministrin. Këtu nënkuptohet se nuk i adresohet drejtpërsëdrejti, bëhet fjalë për institucionet qendrore të nivelit të ministrive e më poshtë. Pra, ato që nuk janë nën përgjegjësinë e tyre. Por ky termi “miratim” duhet sqaruar. Ju jeni profesionistë, jeni më të aftë se ne në këtë pikë, por ka një

të drejtë zonja Hysi, duhet sqaruar, pra, nuk duhet marrë miratimi të shkojë apo të mos shkojë, sepse kjo është një çështje e brendshme.

Për shembull, po marr një institucion të pavarur, Gjykatën Kushtetuese, apo Gjykatën e lartë apo Avokatin e Popullit. Nuk do të marrë miratimin nëse do të shkojë jashtë shtetit apo s' do të shkojë jashtë shtetit. Ai thjesht do të marrë udhëzimin për një qëndrim të caktuar. Miratimin, pëlqimin, nuk e di, por duhet gjetur një term që të mos e bëjë atë urdhërues, pengues, në një farë mënyre. Sot nuk ka gjë në praktikë të kësaj natyre, të kuptohemi, sepse janë ca gjëra që shkruhen në ligje, ca gjëra që kthehen në zakone të mira, të shëndetshme, dhe ky është një zakon i mirë, i shëndetshëm, unë e besoj këtë gjë. Bëj pjesë tek ata që e besojnë, por gjithsesi, për t'i ndërprerë rrugën ndonjë mundësie arbitrare, ku thuhet: nuk do të shkosh, unë të thashë të mos shkoje. Ndoshta ndonjë "pëlqim", nuk e di, duhet gjetur një term. Duhet parë kjo, e këtu edhe ne mund të bëjmë ndonjë propozim konkret. Jam dakord me mendimin e zonjës Hysi e të zotit Majko, që kjo ka nevojë të rishihet, për t'u riformuluar.

Zonja Hysi ngriti një problem, që ka të bëjë me rastet kur pa marrëveshje dypalëshe. Po, dakord! Edhe kjo duhet parë me kujdes. Dakord, nesër mund të shkojë bashkia në një aktivitet të zakonshëm, një aktivitet, një seminar për ujësjellësit. Domethënë, duhet specifikuar qartë kur ka të bëjë me marrëdhënie dypalëshe. Kam një gjë tjetër: që edhe kur janë këto marrëdhëniet, ka ca simbolika. Në qoftë se shkon në një marrëdhënie dypalëshe, kush i përcakton? Protokolli i Shtetit? Ceremoniali? Apo i përcakton ky ligj? Që kur të shkojë ai, duhet të ketë flamurin e tij në tryezë, kur bisedon. E ku e di se çfarë, gjëra të kësaj natyre. Pra, ideja është që, jo për çdo gjë ai duhet të marrë pëlqimin, miratimin. Jo për çdo gjë. Mirë, pra, thamë se do të gjejmë një gjë më të butë. Apo miratimin, siç thotë zonja Hysi. Nga ana tjetër është sjellja e të gjithë këtyre që përfaqësojnë shtetin në një rast të tillë. Jo thjesht e vetëm të mbështetur te këto udhëzime të Ministrisë, që janë detyrueshme, si organi përgjegjës për përpunimin e politikës së jashtme, pore dhe sjellja, edhe qasja e tyre në raport me figurën e dinjitetit të shtetit, që përfaqësojnë.

Këto ishin komentet e mia personale.

Qirjako Qirko – Unë së pari dua t'ju falënderoj, sepse shqetësimet tuaja kanë qenë gjithmonë shqetësimet tona. Pra, nëse i referohemi rastit kur kemi kërkuar që diplomatët të jenë pjesë e stafeve këshillimore, po themi politike, të ministrave, jemi përpjekur, dhe në fare pak raste është bërë e mundur kjo. Pra, mund të kemi dy-tre raste dhe i kemi realizuar nëpërmjet kontratave, sepse në fund të fundit ajo është një zgjedhje që e bën vetë ministri në këto raste.

Jemi shumë dakord me atë kërkesën që ju përmendët, që në përfundim të aktiviteteve diplomatike të informohet Ministria e Jashtme. Në këtë drejtim ka mjaft vend për të përmirësuar. Në qoftë se kemi këmbëngulur që veçanërisht me pushtetin vendor dhe institucionet e tjera qendrore, të përcaktohet në ligj, kemi këmbëngulur për faktin se ky aktivitet është rregulluar me vendim të Këshillit të Ministrave. të themi të drejtën janë jo të shumta bashkitë apo institucionet qendrore – i kemi specifikuar tashmë në çdo vizitë që bën iks bashki informon çfarë u diskutua, çfarë u arrit.

Ne e kemi memorien tonë dhe në çdo rast e dimë çfarë është bërë konkretisht. Por nuk e bëjnë të gjitha bashkitë këtë. Pra, na ka munguar edhe një mekanizëm i kërimit të llogarisë në këtë drejtim, dhe kjo është arsyeja pse kemi dashur që këtij momenti t'i japim një peshë më të madhe, duke e vendosur në ligj. Jam absolutisht dakord me të gjitha shqetësimet që u ngritën këtu për këtë çështje, që do të gjejnë reflektim ndoshta.

Vasilika Hysi – Po, faleminderit, zoti kryetar edhe për diskutimin tuaj dhe për qëndrimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme!

Unë kam një sugjerim lidhur me fjalën “institucione qendrore”, meqenëse institucioni i Presidentit, i Kryeministrit dhe i Kryetarit të Kuvendit rregullohen me nenin 13, të themi: Ministrinë, institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe të Ministrit dhe organet e pushtetit vendor ushtrojnë veprimtarinë e tyre, duke ua lënë të drejtën këtyre tre institucioneve.

(Diskutim pa mikrofon)

Aty duhet të jetë në kuadër të fjalës, opinionit. Nuk mund të miratojë kërkesën Kryetari i Gjykatës së Lartë, që merr një ftesë nga homologu i vet, Avokati i Popullit ose Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, t'i thotë Ministrit të jashtëm që do të shkojë apo nuk do të shkojë. Por, të kemi një paragraf të prerë për institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet qendrore, ose te neni 13, ku të thuhet që të bashkërendojnë qëndrimet për institucionin e Presidentit, Kuvendit e Këshillit të Ministrave e institucionet e tjera qendrore.

Tek neni 13, ku thuhet Ministria e Punëve të Jashtme, te paragrafi i dytë, theksohet: “përveç funksioneve të përgjithshme të shërbimit të jashtëm, Ministria e Punëve të Jashtme a – Bashkërendon qëndrimet zyrtare për institucionin e Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, institucionet e tjera qendrore os institucionet kushtetuese për çështjet e politikës së jashtme”, por ju nuk mund t'u thoni se çfarë do të flasin ata për bashkëpunimin, binjakëzimin, trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve e të tjera. Pra, gjithmonë në fushën e politikës së jashtme.

Gjithashtu, gjithmonë për nenin 9, te paragrafi i parë, mbështes idenë time dhe atë që tha edhe zoti Xhafaj, për të bërë dallimin e asaj që thuhet “miratim”. Pra, nuk mundet që t’i miratoni ju vizitën Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, por duhet të jepni opinione, duhet të jepni udhëzime. Pra, ta ndajmë këtë pjesën.

(Diskutim pa mikrofon)

Për aq kohë sa është “institucione qendrore”.

Tani, me diferencimin që i bëjmë.

(Diskutim pa mikrofon)

Po. këto janë.

Tani, lidhur me propozimin që është bërë edhe nga ana ime si relatore, por e rikonfirmoi më me forcë edhe kryetari i komisionit, të gjitha grupet që shkojnë kanë nevojë të kenë një informacion, me qëllim që ju të bashkërendoni të gjithë politikën e jashtme. Jo vetëm të dini çfarë është bërë dhe të ketë një ndjekje një follow up, por edhe të bashkërendoni politikën e jashtme dhe të ndihmoni, të sugjeroni, për shembull për ecuritë, sidomos në kuadër të reformës territoriale, bashkëpunimi rajonal ndërkufitar, ka nevojë të ketë vlerësimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në kuadër të projekteve.

Prandaj, gjithë shqetësimi është vetëm te ca saktësime të vogla te neni 9, te paragrafi i parë. Për mua nuk ka problem, por në praktikë mund të lindë probleme të keqinterpretimit.

(Diskutim pa mikrofon)

Qirjako Qirko – Po, patjetër do t’i miratojë. Ministri i Jashtëm e miraton, jo strukturat e larta. Nivel ministri e poshtë. Pse? Sepse ka një fluks. Pra, qëllimisht, një iks vend, në një moment që ke një marrëdhënie të caktuar, ai nuk lë aktivitet që zhvillohet në atë vend, dypalësh apo shumëpalësh, pa u dërguar ministrave shqiptarë. Është gjest, dhe çdo gjest në këtë drejtim, nëse çdo ministër, fjala vjen, do të shkonte pse i vjen një ftesë, atëherë do të krijonte një imazh që s’ka të bëjë me qëndrimin tonë ndaj vendit konkret. Pra, nëse ndaj një vendi ka një embargo të caktuar për një çështje të caktuar, dhe ai të dërgon ftesa, Ministria e Jashtme thotë: Ndal, sepse shkojmë deri në këtë nivel. Pra, në këtë rast miraton. Nuk ka zgjidhje tjetër. Bile edhe për vizitat, edhe për përfaqësitë që kemi.

Në vazhdim të diskutimit, unë mendoj se ne duhet t’i njohim disa të drejta Ministrisë së Jashtme, ashtu siç u shprehën këtu edhe kolegët parafolës, në ekskluzivitetin që kjo Ministri e jashtme ka me politikën e jashtme. Kështu që, mendojs e kjo shprehja që ka krijuar keqkuptim,

që ka të bëjë me dhënien e miratimit, dhe duket se po s'ë dha miratimin nuk ndodh, mendoj se kjo mund të shikohet teknikisht më vonë, koordinuar me udhëzimet e Ministrisë së Jashtme. Pra, të gjitha këto institucione mbajnë qëndrime, bëjnë deklarata që lidhen me marrëdhëniet me jashtë, të koordinuara me udhëzimet e Ministrisë së Jashtme. Po e kam fjalën tani te kjo puna e ekskluzivitetit. Mendoj se Ministria e Jashtme duhet, ashtu siç u tha, të informohet për çdo veprim të rëndësishëm, që ka të bëjë me marrëdhëniet me jashtë, të çdo lloj institucioni në Shqipëri.

Tani po ritheksoj diçka që, sipas meje, mendoj se duhet. Ministria e Jashtme ka të drejtë të kërkojë anulimin e vizitës. Në një situatë të caktuar, në një moment të caktuar, Ministrisë së jashtme i duhet njohur e drejta që t'i kërkojë përfaqësuesit të një institucioni, cilido qoftë ai, anulimin e vizitës. Sigurisht, shoqëruar me komentet dhe arsyetimin përkatës. Kjo, mendoj, e bën ekskluziv rolin e Ministrisë së Jashtme, duke shmangur çdo lloj keqkuptimi.

Mendoj se në një moment të caktuar, shteti ynë mund të ndodhet në një situatë të caktuar me një shtet tjetër, dhe asnjë institucion tjetër nuk mund t'i shmanget kësaj marrëdhënieje bilaterale, që do të kërkojë sigurisht, në çdo rast opinionin e pacaktuar dhe profesional të Ministrisë së Jashtme.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Unë do të flas shumë shkurt dhe dua të të falënderoj, zoti kryetar i komisionit, për shqetësimin dhe komentet që bërë në fillim, sepse, sinqerisht, çështjet e politikës së jashtme nuk janë thjesht çështje të një ligji, por kanë lidhje me përfaqësimin dinjitoz të shtetit shqiptar në marrëdhëniet me jashtë. Shqetësimet që ju ngritët, por që i përforcoi edhe kolegja Hysi e zoti Majko, është e udhës të gjejnë një përcaktim edhe në ligj, sepse, jo vetëm që duhet të informohet Ministria e Jashtme për të gjitha aktivitetet që zhvillojnë delegacione të ndryshme të institucioneve qendrore, por edhe ato lokale, nëse do të ketë pas ndarjes së re territoriale. Këto delegacione duhet të pajisen nga Ministria e Punëve të Jashtme me informacion ose personat konkretë që janë pranë institucioneve qendrore, që do të jenë në koordinim me Ministrinë e Jashtme, lidhur me tematikën që do të diskutohet në këto aktivitete të nivelit të lartë jashtë Shqipërisë. Unë dua të vij në një rast konkret.

Para disa kohësh bashkë me kolegen Hysi dhe zotërinjtë Ndoka dhe Muhedini kemi qenë në një aktivitet ndërkombëtar nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me rolin e pakicave në vendimmarrje në Serbi, pra në vendet e rajonit, por delegacioni ynë sigurisht që kishte bërë një

përgatitje individuale lidhur me tematikën e konferencës që zhvillohej, pa pasur asnjë informacion paraprak qoftë nga Ministria e Punëve të Jashtme, qoftë nga shërbimi i jashtëm i Kuvendit për të bërë një përfaqësim dinjitoz në atë konferencë, gjë e cila reflektohej qartazi edhe te delegacionet e tjera në atë konferencë.

Dua të falënderoj me këtë rast kolegen Hysi, sepse sigurisht trajtimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, rolit të pakicave ishte fusha e saj, por roli i Ministrisë së Jashtme në këtë drejtim duhet të jetë parësor, sepse, në fund të fundit, këtë të drejtë ia njeh Kushtetuta dhe ligji, si dhe shqetësimet që ngritën kolegët e mi duhet të gjejnë reflektim edhe në ligj.

Për sa i përket çështjes së informimit, sigurisht që një delegacion sapo kthehet, një memo e shkurtër Ministrisë së Jashtme dhe institucionit që e ka nisur në këtë konferencë duhet të jetë diçka e shkruar, sepse, në fund të fundit, lidhet me politikën e jashtme dhe me dinjitetin e shtetit shqiptar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Qirjako Qirko – Gjithçka që ka të bëjë me rritjen e përgjegjësisë, me rritjen e koordinimit dhe të bashkëpunimit gjithmonë është gjetur gatishmëri nga Ministria e Jashtme për të dhënë...

Ishte rasti i minoriteteve. Ne kemi një sektor që merret me minoritetet, që përgatit raportet dhe gjithë korrespondencën. Kështu që, kur na kërkohet, ne nuk e kursejmë në asnjë rast këtë ndihmë.

Jemi dakord me të gjitha mendimet që u thanë këtu për sa u takon rritjes dhe përmirësimit të bashkëpunimit të të gjitha institucioneve.

Dua ta përsëris edhe një herë, nëse bëhet fjalë për miratime, nuk bëhet fjalë për autoritetet më të larta shtetërore, ndoshta do të thosha kushtetuese, për ta diferencuar nga pjesa tjetër e autoriteteve. Pra, gjithmonë bëhet fjalë në nivel ministri e poshtë. Është e nevojshme edhe të miratojë. Të gjithë e dimë se ndonjëherë ka edhe nxitime. Merret një ftesë dhe shkohet, madje edhe në ftesa nga përfaqësitë diplomatike. Pse duhet ta ketë Ministria e Jashtme protokollin? E ka siç e ka e gjithë bota. Në çdo rast ne e dimë se si është festuar festa kombëtare e Shqipërisë në një iks vend dhe në çfarë niveli ka ardhur vendi përkatës. Edhe në këtë drejtim ka hapa, por roli miratues dhe koordinues është i domosdoshëm në çdo rast kur shkojmë me autoritetet e larta, ndërkohë që në vendin konkret përfaqësohemi në nivel specialisti të Ministrisë

së Jashtme, sepse kemi pasur raste të tilla. Pra, pikërisht për ta disiplinuar, për t'i dhënë fytyrë, për t'i dhënë seriozitet është i domosdoshëm ky lloj përqendrimi te Ministria e Jashtme.

Nuk është ndonjë dëshirë, por në këtë drejtim është një praktikë që e ka e gjithë bota. Çdo shtet serioz e ka të përqendruar këtë aktivitet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë gjë tjetër?

E mbyllim këtu këtë diskutim.

Zonja Hysi le të përgatisë materialin që do t'i kalojë Komisionit të Jashtëm në bashkëpunim edhe me zotin Qirko për të konsultuar dy-tre terma që ramë dakord këtu për t'i saktësuar, edhe ndonjë gjë e re që duhet shtuar të shtohet si propozim i këtij komisioni për pjesët e këtyre tre neneve.

Kuorumi është. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, më falni, paskam folur pa mikrofon!

Atëherë, për sa i përket projektligjit “Për shërbimin e jashtëm”, qëndrimi i këtij komisioni lidhur me dispozitat e kërkuara për amendim u miratua për t'i kaluar Komisionit të Politikës së Jashtme.

Sekretar
Armando Subashi

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.03.2015, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Pirro Lutaj, A. Prenga, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi, Petrit Vasili

Fatmir Xhafaj – Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi nismën ligjore për miratimin e projektligjit “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”, e paraqitur nga deputetja Mesila Doda dhe deputeti Shpëtim Idrizi. Edhe zonja deputete, edhe zoti deputet nuk janë paraqitur.

Zonja deputete ka njoftuar përfaqësuesin e partisë së saj, zotin Bylykbashi, se do të jetë jashtë shtetit, kurse për zotin Idrizi nuk jam në dijeni të ndonjë njoftimi.

Për korrektesë dhe për transparencë me mediet, me gazetarët që janë të pranishëm, nga zonja Doda dhe zoti Idrizi është kërkuar që ky projektligj të paraqitet nga organizatat e shoqërisë civile. Kjo nuk mund të ndodhë, sepse nuk e lejon as Kushtetuta, as Rregullorja.

Të drejtën e nismës ligjore, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ka qeveria, një a më shumë deputetë dhe mbi 50 mijë zgjedhës, që do të thotë se një nismë e paraqitur prej tyre duhet të paraqitet nga këto tre subjekte kushtetuese dhe janë ato që duhet ta paraqesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kuptoj shumë mirë. Ndoshta shqetësimi i tyre është se nuk e njohin projektin dhe kanë firmosur se ua kanë dhënë të tjerët, por nuk është përgjegjësi e këtij komisioni të zhbëjë Rregulloren dhe të shkelë Kushtetutën.

Natyrisht, është detyrim i tyre që të vijnë të paraqiten në komision dhe të bëjnë prezantimin, në mënyrë që të fillojë diskutimi dhe debati për projektin e tyre. Pastaj, ata mund të kërkojnë që grupe të interesuara, organizata të shoqërisë civile e të tjera të dëgjoen dhe komisioni, sipas procedurës, mund të procedojë normalisht. Kjo që po ndodh nuk është shumë korrekte konform procedurës. Nuk ka asnjë nen që ta justifikojë që komisioni të njohë për prezantues projektligji një organizatë të shoqërisë civile.

Komisioni mund të dëgjojë, siç ka dëgjuar me dhjetëra dhe qindra raste, organizata të shoqërisë civile, grupe të interesuara dhe individë këtu për çështje të ndryshme, por ata nuk mund të kenë të drejtën e paraqitjes dhe të mbrojtjes së projektligjit. Pse? Sepse ka edhe një problem tjetër. E zëmë se për një moment ne e bëmë këtë gjë këtu, po në seancë çfarë mund të ndodhë? Në seancë mund të ketë pyetje dhe kush do të përgjigjet? Deputetët propozues. Kjo është logjika. Ne kemi lënë gjithë kohën e nevojshme që deputetët propozues ta asimilonin lëndën që kishin nënshkruar dhe të vinin këtu të bënë një pakt të pakten një ekspozë. Gjithsesi, ne do të vazhdojmë për të proceduar. Do t'i bëjmë edhe një thirrje të fundit të tre kolegëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kanë kopjuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk e ka nënshkruar. Kur ta nënshkruajë edhe ai, nuk vjen dot. Askush. Edhe një i tretë nuk mund të vijë sa kohë që nuk ka këtu nënshkrimin.

E mbani mend? Këtu janë bërë debate kur ka pasur dy herë emrin një person dhe nuk është konsideruar numri i nevojshëm. Këto janë procedura që nuk mund t'i shkelim. Kursesi nuk mund të ndodhë që t'i shkelim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, është e vërtetë.

Dakord.

Gjithsesi, propozimi që kam unë, meqenëse ne e kemi filluar një proces me iniciativën e qeverisë dhe, pavarësisht se janë dy projekte që nuk rrinë me njëri-tjetrin, për momentin ose së paku njëra nga palët duhet të thotë: “Jam dakord të diskutohen të dyja”.

Unë do të propozoja edhe në emrin tuaj sot që Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut të organizojë brenda kësaj jave disa seanca dëgjimore me grupet e interesit që kanë shprehur dëshirën të dëgjohen. Është rasti këtu që ta theksoj që kush dëshiron, grupe interesi, organizata të shoqërisë civile mund të dëgjohen nga ky komision për të dy këto projektligje, pra edhe për projektligjin e propozuar nga dy deputetët, e nënshkruar prej tyre, edhe për projektligjin e ardhur si iniciativë e qeverisë, pra janë të mirëpritur.

Cilido nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile, që mendon se ka diçka për të thënë lidhur me këto dy projektligje, mund të paraqesë kërkesë pranë Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut dhe nënkomisioni përkatës të organizojë seanca dëgjimore.

Zonja Hysi, do t'ju lutesha që të merrni masa për të organizuar seancat dëgjimore me nënkomisionin tuaj brenda kësaj jave, në mënyrë që javën e ardhshme, për shkak edhe të detyrimit që kemi nga kalendari i Kuvendit, të fillojmë procesin e shqyrtimit të të dy projektligjeve për t'i kaluar në seancë plenare. Gjithsesi, data do të jetë një çështje që do ta diskutojmë në varësi edhe me ngarkesën që ka komisioni.

Nuk mund ta bëjë i gjithë komisioni, sepse komisioni është shumë i ngarkuar. I bie që për të përmbushur detyrimet që kemi ndaj programit dhe kalendarit të bëjmë të paktën tri çështje në ditë që vetë komisioni të mund të kapë programin dhe kalendarin e miratuar nga seanca, përfshirë edhe reformën në drejtësi, që besoj se jeni të gjithë të qartë se po ecën përpara dhe shumë shpejt do të keni produktin e parë publik të grupit të ekspertëve dhe të komisionit të posaçëm.

Ngarkesa imponon që të ketë edhe një shpërndarje racionale ndërmjet komisionit, nënkomisioneve dhe strukturave të tjera.

Biem dakord? E mbyllim këtu?

Faleminderit!

Nesër në orën 10:00 sipas rendit të ditës.

Faleminderit edhe medias për vëmendjen, edhe për interesin, edhe për mirëkuptimin!

MBLEDHJA MBYLLET